



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr 1602/1 Prot.

Tiranë, më 19.06.2023

VENDIM QARKULLUES

Nr. 73 datë 19.06.2023

PËR

SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË SENATIT
NR.69 DATË 13.6.2023 “PËR HAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIM PËR
ANËTAR TË KOMISIONIT TË MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT”
DHE RIHAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIM PËR KËTË KOMISION

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma i) të nenit 38, nenit 46 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 20 (gërma nj) si dhe nenit 26 të Statutit të UST-së, nenit 4 të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Përhershëm në Nivel Institucioni, të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët, nenit 23 të Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST, të Vendimit nr.71, datë 13.06.2023 të Senatit Akademik, Senati me Vendim Qarkullues

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e Vendimit të Senatit nr.69 datë 13.6.2023 “Për hapjen e thirrjes për vetëkandidim për anëtar të Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët”.
2. Rihapjen e thirrjes për vetëkandidim për anëtar të Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët me këtë përbërje:
 - 3 (tre) anëtarë personel akademik
 - 1 (një) anëtar, i cili vjen nga propozimet e Rektoratit
 - 1 anëtar i zgjedhur si përfaqësues i studentëve, kandidaturat e të cilëve vijnë të listuara nga Këshilli Studentor.
3. Regjistrimi i kandidatëve të kryhet pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UST-së për 5 (pesë) ditë pune, nga data 20.06.2023 deri në 26.06.2023
4. Kandidatët e interesuar në momentin e aplikimit duhet të cilësojnë qartë emrin e komisionit ku vetëkandidojnë.
5. Sekretari i Senatit Akademik të përpilojë “Njoftim” për të gjithë të interesuarit me të dhënat e sakta për kriteret, mënyrën, vendin dhe periudhën kohore të aplikimit.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi drejtuesit e njëjësive kryesore si dhe Sekretari i Senatit Akademik.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1602/1 Prot.

Tiranë, më 19.06.2023

VENDIM QARKULLUES

Nr. 73 datë 19.06.2023

PËR
SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË SENATIT
NR.69 DATË 13.6.2023 "PËR HAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIM PËR
ANËTAR TË KOMISIONIT TË MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT"
DHE RIHAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIM PËR KËTË KOMISION

PROF.DR. ADRIATIK META

PROF.DR. DHURATA BOZO

PROF.ASOC. ARBEN KAÇURRI

PROF.ASOC. ROBERT ÇITOZI

PROF.ASOC. BASHKIM DELIA

AMBER URSI

PROF.DR.DHIMITRAQ SKENDERI

PROF.DR. FATOS GJATA

PROF.ASOC. FERDINAND MARA

PROF.ASOC. JUEL JARANI

DR. ELTON SPAHIU

XHEMAL ÇULLHAJ